



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:235323
Datë: 12.06.2024
Numri i dokumentit: 05810937

C.nr.3082/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëses Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, Rr. "P.J" nr..., e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga V.J, avokate me seli në P, kundër të paditurit I.K nga P, Rr. "A.Q" pn, lagja K, me objekt të kontestit regresin e borxhit, vlera e kontestit 3,054.00 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik të dt.11.06.2024, në prezencën e përfaqësueses së autorizuar të paditëses, av. V.J, e në mungesë të palës së paditur, me datën 12.06.2024 mori dhe në të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, ashtu që: DETYROHET i padituri I.K nga P, që në emër të regresit të mjeteve nga aksidenti i komunikacionit i dt.17.11.2016, t'ia rimburojë paditëses shumën e përgjithshme në vlerë prej 3,054.00 € (tre mijë e pesëdhjetë e katër euro), me normën e kamatës ligjore prej 8 % në vit, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, me dt.18.12.2017, e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET i padituri I.K nga P, që paditëses Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 40.00 € (dyzet euro), dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësja Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, pranë kësaj Gjykate me dt.17.10.2018 ka parashtruar padi kundër të paditurit I.K nga P, me objekt kontesti regresin e borxhit. Në referatin e padisë ndër tjera pretendohet se paditësja dhe pronari i automjetit të cilin ditën e aksidentit ishte duke drejtuar i padituri kanë lidhur kontratën mbi sigurimin nga autopërgjegjësia, përkatësisht për kompensimin e dëmit ndaj palëve të treta, sipas policës nr... Tutje theksohet se me datë 17.11.2016, në rrugën nacionale P - F, i padituri ishte duke drejtuar automjetin në gjendje të dehur dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës, hyn në rreth - rrotullim, ku e humbë kontrollin mbi automjetin dhe godet rrethojnën mbrojtëse të N "P", ku pastaj godet automjetin e të

dëmtuarit i cili ishte i parkuar dhe nga pjesët e rrethojës dëmtohet automjeti tjetër i të dëmtuarit N "P", i cili ishte po ashtu i parkuar. Si pasjë e këtij aksidenti, dëme materiale pëson pala e dëmtuar N "P", ndërsa në momentin e aksidentit, i padituri ishte duke drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, në përbërje prej 1.95 %, me çka, konform nenit 14 par 1.3, e ka humbur mbulesën siguroese. Më tej pretendohet se në bazë të nenit 14 par.2 të LSDA-së, paditësja është detyruar që të bëjë pagesën ndaj palëve të treta, sepse humbja e mbulesës siguroese nuk ndikon në të drejtat e tyre. Në këtë mënyrë, paditësja ka pranuar dhe trajtuar kërkesat për kompensimin e dëmit nga i autorizuari i palës së dëmtuar N "P" dhe të njejtën e ka kompensuar në shumën prej 3,054.00 Euro, në emër të dëmit material të pësuar nga aksidenti i datës 17.11.2016. Më tej pretendohet se konform nenin 14 par 1.3 të LSDA-së, si dhe në bazë të dispozitës së nenit 960 par.1 të LMD-së, paditësja ka fituar të drejtën për të kërkuar rimbursimin e shumës së paguar nga i padituri, për arsye se i njejtë e ka humbur mbulesën siguroese. Paditësja i është drejtuar të paditurit me anë të dy kërkesave, duke kërkuar që kjo çështje të mbyllet me marrëveshje jashtëgjyqësore, por i padituri nuk ka bërë përpjekje që të ndodhë një gjë e tillë. Mbi bazën e të lartëcekurave, ka propozuar që gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të merr aktgjykim, me të cilin aprovohet kërkesëpadija e paditëses dhe detyrohet i padituri I.K që në emër të regresit të mjeteve, t'ia rimbursojë paditëses shumën e mjeteve në vlerë prej 3,054.00 € (tre mijë e pesëdhjetë e katër euro), me normën e kamatës ligjore prej 8 % në vit, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kërkesës së parë për rimbursim, e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Gjykata përmes aktvendimit procedural C.nr.3082/18, të dt.12.01.2024, në mbështetje të dispozitës nga neni 394 të LPK-së, padinë me të gjitha shkresat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurit, në mënyrë që t'i ofrohet mundësia e paraqitjes së përgjigjes në padi brenda afatit prej 15 ditësh, në kuptim të dispozitës nga neni 395 par.1 të LPK-së. Nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri aktvendimin e lartëcekur e ka pranuar me dt.18.01.2024, mirëpo nuk ka parashtruar përgjigje në padi brenda afatit të paraparë ligjor.

Në kuptim të dispozitës nga neni 400 par.2 të LPK-së, Gjykata ka konvokuar seancën përgaditore për dt.27.03.2024, seancë kjo e cila sipas propozimit të palës së paditur është shtyrë. Gjykata ka mbajtur seancën përgaditore me dt.20.05.2024, ndërsa atë të shqyrtimit kryesor me dt.11.06.2024. Meqenëse i padituri, përkundër faktit që ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar, Gjykata ka proceduar me mbajtjen e këtyre seancave në mungesë të palës së paditur, në kuptim të dispozitës nga neni 409 par.2, respektivisht 423 par.4 të LPK-së.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.11.06.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, ka administruar provat materiale vijuese: Konfirmimi i sigurimit i dt.26.09.2018; Polica e sigurimit numër ..., e lëshuar me datë 03.03.2016; Raporti i aksidentit numër 2016-AR-3078, i dt.17.11.2016, së bashku me skicën e vendit të ngjarjes; Kërkesa për kompensim, e parashtruar nga M.H, e dt.24.11.2016; Marrëveshjet jashtëgjyqësore, të lidhura me dt.30.12.2016, 13.12.2016, 21.12.2016; Lista e dëmeve e lëshuar nga paditësja e dt.18.01.2017; Konfirmimet e pagesave bankare të dt.23.12.2016 dhe 30.12.2016; Kërkesat për rimbursim të dt.18.12.2017 dhe 31.01.2018; Procesverbali mbi dëmin i dt.24.11.2016 dhe Foto - dokumentacioni i automjeteve të dëmtuara.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga konfirmimi i sigurimit i dt.26.09.2018, respektivisht polica e sigurimit me numër ..., e lëshuar me datë 03.03.2016, vërtetohet fakti se automjeti i markës "A", automjet për pasagjerë, me targa të regjistrimit ..., me pronare E.K, ka qenë i siguruar me kontratë për sigurimin nga autopërgjegjësia për periudhën kohore 03.03.2016 - 03.03.2017.

Nga raporti i aksidentit, numër 2016-AR-3078, i dt.17.11.2016, vërtetohet fakti se me datën e lartëcekur ka ndodhur një aksident i komunikacionit, deri te i cili kishte ardhur kur automjeti "A", i cili ishte në lëvizje në rrugën nacionale P - F, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës, hyn në rreth - rrotullim, e humbë kontrollin mbi automjetin dhe godet rrethojën mbrojtëse të automomjeit "B", ku pastaj godet automjetin e të dëmtuarit i cili ishte i parkuar dhe nga pjesët e rrethojës dëmtohet automjeti tjetër "C", i cili ishte po ashtu i parkuar. Po në këtë raport është konstatuar se automjeti me të cilin ishte shkaktuar aksidenti, i markës "A", me targa të regjistrimit ..., ishte i siguruar tek këtu paditësja sipas policës nr..., ndërsa në momentin e aksidentit ishte duke u drejtuar nga këtu i padituri I.K, i cili ishte nën ndikimin e alkoolit në vlerën prej 1.95 %.

Nga foto - dokumentacioni i automjeteve të dëmtuara nga ky aksident, përkatësisht lista e dëmeve, e lëshuar nga paditësja me dt.18.01.2017, është bërë një bilanc i evidentimit të dëmit material për palët e dëmtuara nga aksidenti i komunikacionit i dt.17.11.2016.

Nga kërkesa për kompensim të dëmit, e parashtruar nga pala e dëmtuar M.H me dt.24.11.2016, vërtetohet fakti se i njëjti i është drejtuar paditëses me kërkesë për kompensimin e dëmit material nga aksidenti i komunikacionit me të dhënat e lartëcekura.

Nga marrëveshja jashtëgjyqësore e dt.30.12.2016, vërtetohet fakti se këtu paditësja ka lidhur marrëveshje me subjektin N "P", për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i dt.17.11.2016, përmes së cilës marrëveshje paditësja është obliguar që palës së dëmtuar t'ia paguajë shumën prej 2,000 Euro. Nga marrëveshja jashtëgjyqësore e dt.13.12.2016, vërtetohet fakti se këtu paditësja ka lidhur marrëveshje me subjektin N "P", për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i dt.17.11.2016, përmes së cilës marrëveshje paditësja është obliguar që palës së dëmtuar t'ia paguajë shumën prej 250.00 Euro. Nga marrëveshja jashtëgjyqësore e dt.21.12.2016, vërtetohet fakti se këtu paditësja ka lidhur marrëveshje me palën e dëmtuar M.H, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i dt.17.11.2016, përmes së cilës marrëveshje paditësja është obliguar që palës së dëmtuar t'ia paguajë shumën prej 804.00 Euro.

Nga konfirmimet e pagesave bankare të dt.23.12.2016 dhe 30.12.2016, vërtetohet fakti se paditësja e ka bërë bartjen e mjeteve në shumat e lartëcekura në xhirollogarinë e palës së dëmtuar.

Paditësja me dt.18.12.2017, respektivisht me dt.31.01.2018, i është drejtuar palës së paditur me kërkesë për rimbursim, duke e njoftuar të njëjtin lidhur me faktin se paditësja ka bërë kompensimin e dëmit material për palën e dëmtuar nga aksidenti i komunikacionit i dt.17.11.2016, si dhe lidhur me detyrimin e të paditurit për rimbursimin e borxhit në procedurë regresi në shumën e përgjithshme

prej 3,054.00 Euro, duke specifikuar se pagesa duhet të bëhet në xhirollogarinë e paditëses brenda afatit prej 30 ditësh, si dhe lidhur me mundësinë e pagesës me këste, përmes arritjes së një marrëveshje rreth pagesës së këtij borxhi.

- Baza ligjore dhe vlerësimi i Gjykatës -

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, marrë parasysh periudhën dhe natyrën e raportit në mes të palëve ndërgjyqëse, Gjykata vlerëson se fillimisht duhet t'i referohemi Ligjit Nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (tani e tutje LSDA), i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.23.06.2011 dhe i shpallur me Dekretin Presidencial të dt.05.07.2011. Dispozita nga neni 1 par.1, e cila i referohet fushëveprimit të ligjit përcakton që: *“Ky ligj rregullon sigurimin nga autopërgjegjësia për dëmet e shkaktuara palëve të treta, që me këtë ligj përcaktohet si sigurim i detyrueshëm”*. Në anën tjetër, dispozita e nenit 14 të të njejtit ligj, e cila i referohet humbjes së mbulesës siguruese, në paragrafin 1, nënparagrafin 1.3 përcakton që: *“I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur: mjeti motorik drejtohet nën ndikimin e alkoolit mbi kufijtë e lejuar, nën ndikimin e lëndëve narkotike apo psiko-aktive”*. Tutje, paragrafi 2 i kësaj dispozite përcakton që: *“Humbja e të drejtave nga sigurimi, siç përcaktohen me dispozitat e paragrafit 1. nën-paragrafët 1.1 deri 1.5, të këtij neni, nuk është me ndikim në të drejtën e palës së tretë në dëmshpërblim”*, ndërsa paragrafi 3 përcakton: *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”*.

Gjykata po ashtu iu referua Ligjit Nr.04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.10.05.2012, i cili ligj ka hyrë në fuqi 6 muaj pas datës së publikimit. Dispozita e nenit 960 par.1 e këtij ligji, e cila flet për kalimin e të drejtave të siguruarit ndaj personit përgjegjës për siguruasin (subrogimin), përcakton që: *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruasin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin.”*

Mbi bazën e të gjitha provave të administruara në këtë çështje juridike, për Gjykatën fillimisht u vërtetua pa mëdyshje fakti se automjeti me të cilin ishte shkaktuar aksidenti i komunikacionit të dt.17.11.2016, i markës "A", automjet për pasagjerë, me targa të regjistrimit ..., në kohën kur është shkaktuar ky aksident ka pasur mbulesë të vlefshme sigurimit pranë paditëses, sipas policës së sigurimit numër ... Automjeti në fjalë në momentin e aksidentit ka qenë duke u drejtuar nga këtu i padituri I.K, i cili ishte nën ndikimin e alkoolit në vlerë prej 1.95 %, që paraqet vlerë mbi kufijtë e lejuar. Konstatimet e tilla janë dhënë në raportin e aksidentit numër 2016-AR-3078, të dt.17.11.2016, ndërsa të gjeturat nga ky raport, Gjykata i merr si të mirëqena për faktin se nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve, e në referim të dispozitës së nenit 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton që: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Një rrethanë e tillë prodhon për pasojë humbjen e mbulesës siguruese, në kuptim të dispozitës nga

neni 14 par.1, nënpar 1.3 të LSDA-së. Megjithatë, rrethana e lartëcekur, në kuptim të paragrafit 2 të nenit 14 të LSDA-së, nuk ndikon në të drejtën e palëve të treta për të realizuar dëmshpërblim. Referuar kësaj dispozite, sipas kërkesës së palës së dëmtuar, paditësja rezulton që e ka shpërblyer dëmin i cili ka rrjedhur nga aksidenti i dt.17.11.2016, veprim ky i cili fillimisht është materializuar përmes marrëveshjeve jashtëgjyqësore të dt.13.12.2016, 21.12.2016 dhe 30.12.2016, përmes së cilave marrëveshje paditësja është obliguar që palëve të dëmtuara t'ua kompensojë shumën e përgjithshme në vlerë prej 3,054.00 €, ndërsa përmbushja e obligimeve nga marrëveshjet e lartëcekura është vërtetuar në bazë të konfirmimeve të pagesave bankare të dt.23.12.2016, respektivisht dt.30.12.2016.

Me rastin e përmbushjes së një detyrimi të tillë, palës paditëse i ka lindur e drejta që në kuptim të paragrafit 3 të nenit 14 të LSDA-së, respektivisht nenit 960 par.1 të LMD-së, të kërkojë rimbursim në procedurë të regresit ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, në rastin konkret ndaj palës së paditur.

Bazuar në faktin se pala paditëse rezulton që i është drejtuar të paditurit, fillimisht me kërkesën e dt.18.12.2017, e më pas edhe atë të dt.31.01.2018, lidhur me rimbursimin e dëmit në vlerën prej 3,054.00 Euro, kërkesa këto për të cilat i padituri nuk rezulton të ketë dhënë përgjigje, Gjykata vlerëson se paditësja është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet që: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurin I.K nga P, që në emër të regresit të mjeteve nga aksidenti i komunikacionit i dt.17.11.2016, t'ia rimburojë paditëses shumën e mjeteve në vlerë prej 3,054.00 € (tre mijë e pesëdhjetë e katër euro), me normën e kamatës ligjore prej 8 % në vit, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, me dt.18.12.2017, e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit. Me rastin e vendosjes, Gjykata mori në konsideratë dispozitën nga neni 2 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendosë brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.”*

Gjykata vë në dukje faktin se në rastin konkret pala e paditur nuk ka parashtruar përgjigje në padi, respektivisht nuk ka prezantuar në seancën përgaditore dhe atë të shqyrtimit kryesor, duke e humbur në këtë mënyrë mundësinë e paraqitjes së prapësimeve të karakterit procedural apo material në raport me padinë e ushtruar ndaj të njejtit. Thënë këtë, Gjykata vendimin e ka mbështetur në provat e prezantuara nga pala paditëse, mbi bazën e të cilave formësohet bindje e mjaftueshme dhe e qartë në raport me vlerësimin e themelësisë së kërkesëpadisë.

- Vendimi lidhur me kamatën -

Gjykata në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi edhe lidhur me kërkesën aksesore, duke e detyruar të paditurin që shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë

paditëses së bashku me normën e kamatës ligjore prej 8% në vit, e cila për do të llogaritet nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, dt.18.12.2017, e deri në pagesën definitive, Një vendosje e tillë gjen mbështetje në dispozitën nga neni 382 të LMD-së, e cila parasheh që: "*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*". Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020.

- *Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës* -

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1, 454 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurin që palës paditëse t'ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme në këtë procedurë, sipas kërkesës së specifikuar, në vlerë të përgjithshme prej 40.00 Euro, dhe atë: në emër të taksës gjyqësore për padi.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të dispozitës së nenit 142, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitivtë këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL -
C.nr.3082/18, datë 12.06.2024

G j y q t a r i,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 176 të LPK-së, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të njejtë. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.